



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e datës 31 tetor 2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes më 07 nëntor 2022, mori këtë,

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021, dhe atë:

1.1. **z.Haki Rudari**, emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të z.Florent Hasani i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

1.2. **znj.Drita Pajaziti**, emërohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Adelinë Stublla, e cila për arsye të emërimit në funksion ekzekutiv në Komunën e Podujevës, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga Kuvendi i Komunës, respektivisht nga pozita e anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-020/04-0093828/22  
Podujevë, datë; 07 nëntor 2022



Kryesuesi i Kuvendit  
**Hilmi Hoxha**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	31/12/2021	
Ndërllog Urg. loc.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
01-020/04-0111883/21		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 5 dhe 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, si dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, dhe e vazhduar më 30 dhjetor 2021, mori këtë;

### VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

#### Neni 1

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1- **Hilmi Hoxha**, Kryesuesi i Kuvendit (sipas pozitës)
- 2- **Naim Çunaku**, nga subjekti politik LDK
- 3- **Qëndrim Softolli**, nga subjekti politik LDK
- 4- **Arnisa Sylejmani**, nga subjekti politik LDK
- 5- **Adelinë Stublla**, nga subjekti politik LVV
- 6- **Florent Hasani**, nga subjekti politik LVV
- 7- **Sebastina Vokrri**, nga subjekti politik LVV
- 8- **Bashkim Sylja**, nga subjekti politik PDK
- 9- **Mrika Thaçi**, nga subjekti politik AAK

#### Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual mund bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.


#### Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.01-020/04-0111883/21  
Podujevë,  
30 dhjetor 2021



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha